



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:179301

Datë: 05.07.2024

Numri i dokumentit: 05901192

C.nr.734/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.B, B.B, H.B dhe N.B, që të gjithë nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë, vlera e objektit të kontestit 1, 300.00 euro, jashtë seancës, më datën 05.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.B, B.B, H.B dhe N.B.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 31.12.2021 për 160 ditë pune të ja paguajë shumën prej 320.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 14.08.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B.B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 31.12.2021 për 165 ditë pune të ja paguajë shumën prej 330.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 14.08.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit H.B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 31.12.2021 për 165 ditë pune të ja paguajë shumën prej 330.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 14.08.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën

definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit N.B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 31.12.2021 për 160 ditë pune të ja paguajë shumën prej 320.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 14.08.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

VI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve A.B, B.B, H.B dhe N.B, t’i paguajë shumën prej 281.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit A.B, B.B, H.B dhe N.B, më datën 14.08.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë në shumën e përgjithshme prej 1,300.00 euro.

Të njëjtit sipas padisë kanë theksuar se janë në marrëdhënie pune si mësimdhënës në SHMFU “Rudolf Walther”, në fshatin Dejnë, Komuna e Rahovecit, ku edhe janë duke punuar në këtë institucion, e që duke llogaritur për periudhën kohore nga data 21.01.2021 deri më 31.12.2021, paditësve i takon e drejta e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, shuma prej 2 euro, por që deri më tani nuk janë kompensuar. Në bazë të lartcekurave dhe duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të punës përkatësisht nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 21.01.2021, e cila përcakton kompensim për ushqim gjatë punës. Andaj, i kanë propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 07.02.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi padia e paditësve nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse rezulton se është e pavlefshme. Po ashtu më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Duke shtuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. Po ashtu kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/2670/2023, i datës 22.05.2023, i lëshuar nga SHFMU “Rudolf Walther”, në fshatin Dejnë; kontratën e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 01/1401, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit A.B; vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/2684/2023, i datës 22.05.2023, i lëshuar nga SHFMU “Rudolf Walther”, në fshatin Dejnë; kontratën e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 01/1450, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit B.B; vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/2686/2023, i datës 22.05.2023, i lëshuar nga SHFMU “Rudolf Walther”, në fshatin Dejnë; kontratën e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 01/1451, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit Hysni Bytyqi; vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/2661/2023, i datës 22.05.2023, i lëshuar nga SHFMU “Rudolf Walther”, në fshatin Dejnë dhe kontratën e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 01/1412, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit N.B,

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kanë të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësit për periudhën e kërkuar kohore kanë prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë, dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura, si dhe a është parashkruar kërkesa.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/2670/2023, i datës 22.05.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.B, në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 31.12.2021 ka prezantuar në punë në 160 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/1401, e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditësi A.B dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Rudolf Walther” në fshatin Dejnë, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/2684/2023, i datës 22.05.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.B, në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 31.12.2021 ka prezantuar në punë në 165 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/1450, e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditësi B.B dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Rudolf Walther” në fshatin Dejnë, Komuna e Rahovecit

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/2686/2023, i datës 22.05.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi H.B, në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 31.12.2021 ka prezantuar në punë në 165 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/1451, e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditësi H.B dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Rudolf Walther” në fshatin Dejnë, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/2661/2023, i datës 22.05.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi N.B, në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 31.12.2021 ka prezantuar në punë në 160 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/1412, e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditësi N.B dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Rudolf Walther” në fshatin Dejnë, Komuna e Rahovecit.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve për faktin se paditëset në periudhën kohore nga data 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e tyre të punës kanë prezantuar dhe atë paditësi A.B ka prezantuar në 160 ditët e punës, paditësi B.B ka prezantuar në 165 ditët e punës, paditësi H.B ka prezantuar në 165 ditët e punës, si dhe paditësi N.B ka prezantuar në 160 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësit kanë qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*. Në rast se shumëzohen 160 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro të paditësit A.B, për secilën ditë të prezencës në punë, do të kemi shumën e përgjithshme prej 320 euro, në rast se shumëzohen 165 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro të paditësit B.B, për secilën ditë të prezencës në punë, do të kemi shumën e përgjithshme prej 330 euro, në rast se shumëzohen 165 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro të paditësit Hysni Bytyqi, për secilën ditë të prezencës në punë, do të kemi shumën e përgjithshme prej 330 euro, si dhe në rast se shumëzohen 160 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro të paditësit N.B, për secilën ditë të prezencës në punë, do të kemi shumën e përgjithshme prej 320 euro.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të

obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësve është dorëzuar më datën 14.08.2023, ndërsa kërkesëpadia e paditësit përfshin periudhën kohore prej datës 21.01.2021 deri me datën 31.12.2021. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.734/2023, më datën 05.07.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.